



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prijmljeno/Prodato Received/Delivery	19 - 08 2022	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Ni Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSKK	4821/2022		116



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.600/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari Arben Mehmeti-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.600/2022 të datës 06.07.2022 e parashtruar nga ankuesi me adresë:

kundër Vendimit numër:1403/2022 të Zv. Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve i datës 30.06.2022, në çështjen juridike "Transfer", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 19.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.600/2022 e datës 06.07.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. SHFUQIZOHEN Vendimi numër:1403/2022 i datës 30.06.2022 për transferimin e ankuesit si dhe Vendimi me numër:1432/2022 i datës 01.07.2022 të nxjerra nga Zv. Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve
- III. OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij, duke e kthyer ankuesin në vendin e tij të punës sipas të akt emërimit të datës 09.02.2015 me numër prot:47.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## Arsy e t i m

Ankuesi, ipas shkresave të lëndës i punësuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, Vendimit numër:1403/2022 të Zv. Sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve i datës 30.06.2021, ka parashtruar ankesë me datë 30.06.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil me pretendimet ankimore se vendimi për transfer është nxjerrë mbi bazën e shkeljeve të ligjit material, shkeljeve procedurale dhe konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe bazës juridike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 13.07.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse te Ministria e Punëve të Brendshme. Këshilli me datë 20.07.2022 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 30.06.2022 me numër protokolli 3934/2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Akt emërimit e ankuesit të datës 09.02.2015 me numër prot:47; Formularin e vlerësimit në punës pr ankuesin i viti 2021; Vendimit numër:1403/2022 të Zv. Sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve i datës 30.06.2022; Vendimit numër:1432/2022 të Zv. Sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve i datës 01.07.2022; E-mailin e datës 16.09.2021; E-mailin e datës 22.09.2021; Vendimin e Komisionit Disiplinor të MFPT i datës 03.11.2021; E-mailin e datës 07.10.2021 dërguar nga ankuesi për Sekretarin e Përgjithshëm me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 25.10.2021 dërguar nga F.I për ankuesin; E-mailin e datës 01.03.2022 dërguar nga ankuesi për Sekretarin e Përgjithshëm me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 29.10.2021 dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm për ankuesin; Vendimin e datës 01.11.2021; Vendimin e datës 01.11.2021 me numër prot:182; Vendimin e datës 01.11.2021 me numër:183; Njoftimin e datës 31.03.2022; Vendimin e datës 21.04.2022 të kryesuesit të komisionit të rekrutimit; Vendimin e datës 21.04.2022 të Kryesuesit të Komisionit të rekrutimit për titullin e vendit të punës Ndihmës Mjekësor; E-mailin e datës 28.03.2022 dërguar nga ankuesi për Sekretarin e Përgjithshëm; E-mailin e datës 04.02.2022 dërguar nga Njoftimin për rezultatin e verifikimit paraprak datës 01.02.2022; E-mailin e datës 01.11.2021 dërguar nga ankuesi; Njoftimin e datës 10.11.2021; E-mailin e e datës 24.03.2022 dërguar nga ankuesin; E-mailin e datës 24.01.2022 dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm për ankuesin; E-mailin e datës 13.01.2022 dërguar ankuesi për Sekretarin e Përgjithshëm; Draft-Vendimin e datës 17.01.2022; E-mailin e datës 24.03.2022 dërguar nga ankuesin; E-mailin e datës 22.03.2022 me numër:99/2022; E-mailin e datës 20.01.2022 dërguar nga ankuesi për Sekretarin e Përgjithshëm; E-mailin e datës 20.01.2022 dërguar nga ankuesi për Njoftim për anulimin e procedurës së konkursit në pritje i datës 20.01.2022; Konkursin e shpallur të datës 03.02.2022; E-mailin e datës 16.02.2022 dërguar nga ankuesin; E-mailin e datës 18.02.2022 dërguar nga ankuesin për Sekretarin e Përgjithshëm; E-mailin e datës 18.02.2022 dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm për Drejtorët e MPMS; E-mailin e datës 02.03.2022 dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm për ankuesin; E-mailin e datës 01.03.2022 dërguar nga ankuesin; E-mailin e e datës 23.05.2022 dërguar nga ankuesi për Sekretarin e përgjithshëm; Draft-Kontratën e punës për kohë të pacaktuar e datës 01.06.2022; E-mailin e datës 22.04.2022 dërguar nga ankuesi për Sekretarin e Përgjithshëm; E-mailin e ankuesit të datës 04.2020 dërguar për ankuesin dhe të tjerët me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 19.03.2020 dërguar nga ankuesi për ankuesin dhe të tjerët me

korrespondencën e bashkangjitur; Listën e deklaramit të rregullt vjetor; E-mailin e datës 28.06.2022 dërguar nga ankuesi për Sekretarin e Përgjithshëm me korrespondencë e bashkangjitur; E-mailin e datës 19.08.2021 dërguar nga ankuesi për E-mailin e datës 11.08.2021 dërguar nga ankuesi për Agjencinën Kundër Korrupsionit; Vendimin e datës 17.12.2019 të Sekretarit të përgjithshëm të MPMS; E-mailin e datës 20.06.2022 dërguar nga ankuesi për Këshillin; E-mailin e datës 20.06.2022 dërguar nga ankuesi për Sekretarin e Përgjithshëm; E-mailin e datës 20.06.2022 dërguar nga ankuesi për me korrespondencën e bashkangjitur prej 7 faqesh; E-mailin e datës 09.06.2022 dërguar nga ankuesi për Sekretarin e Përgjithshëm; Vendimin e datës 14.06.2022 me numër:203/2022 të Sekretarit të Përgjithshëm; Vendimin e datës 11.11.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm; Vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm i datës 03.10.2019; Njoftimin e datës 11.10.2019 dërguar nga ankuesi për Kryetarin e Gjykatës së Apelit; E-mailin e datës 21.06.2022 dërguar nga ankuesi për Sekretarin e Përgjithshëm me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 04.03.2022 dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 04.03.2022 dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm për ankuesin; E-mailin e datës 11.03.2022 dërguar nga Sekretari i përgjithshëm për ankuesin; E-mailin e datës 09.03.2022 dërguar nga ankuesi për E-mailin e datës 21.06.2022 dërguar nga ankuesi për Sekretarin e Përgjithshëm me korrespondencën e bashkangjitur; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 13.07.2022; Përgjigja në kërkesë e datës 20.07.2022 me numër prot:4213/2022; Vendimin e datës 01.07.2022 me numër:229/2022 të Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore; Vendimin e datës 01.07.2022 me numër:230/2022 të Sekretarit të Përgjithshëm; Përshkrim e detyrave të punës për pozitën Zyrtar Ligjor 2; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punës së ankuesit i datës 29.01.2021; Formulari i vlerësimit të Rezultateve në punë për zyrtaren për vitin 2021; E-mailin e datës 20.06.2022 dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur me korrespondencën e bashkangjitur prej 7 faqesh; E-mailin e datës 03.06.2022 dërguar nga ankuesi për Sekretarin e Përgjithshëm; E-mailin e datës 29.06.2022 dërguar nga ankuesi për Sekretarin e Përgjithshëm; E-mailin e datës 28.06.2022 dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur 3 faqesh; E-mailin e datës 29.06.2022 dërguar nga për Sekretarin e Përgjithshëm; E-mailin e datës 27.06.2022 dërguar nga ankuesi për me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 09.06.2022 dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm për ankuesin; E-mailin e datës 26.05.2022 dërguar nga ankuesi për Sekretarin e Përgjithshëm; E-mailin e datës 26.05.2022 dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 16.11.2021 dërguar nga për Sekretarin e Përgjithshëm me korrespondencën e bashkangjitur prej 2 faqesh; E-mailin e datës 18.11.2021 dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm për ankuesin; E-mailin e datës 27.04.2022 dërguar nga ankuesi për Sekretarin e Përgjithshëm; E-mailin e datës 22.04.2022 dërguar nga për ankuesin; E-mailin e datës 14.06.2022 dërguar nga për ankuesin; E-mailin e datës 01.04.2022 dërguar nga ankuesi për Sekretarin e Përgjithshëm; E-mailin e datës 28.03.2022 dërguar nga ankuesi për Sekretarin e Përgjithshëm; E-mailin e datës 19.04.2022 dërguar nga ankuesi për Sekretarin e Përgjithshëm; E-mailin e datës 09.11.2021 dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm për ankuesin; E-mailin e datës 10.11.2021 dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm për ankuesin; E-mailin e datës 10.11.2021 dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm për ankuesin; E-mailin e datës 04.11.2021 dërguar nga për ankuesin; E-mailin e datës 07.10.2021 dërguar nga ankuesi për Sekretarin e Përgjithshëm; E-mailin e datës 26.05.2022 dërguar nga për Sekretarin e Përgjithshëm.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është e bazuar*, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave mbi bazën e shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi sipas Aktit të emërimit me numër:47 të datës 20.01.2015 është i emëruar Udhëheqës i Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ndërsa sipas përshkrimit të detyrave të punës dhe akti të lartcekur i njëjti i raporton Drejtorit të Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme, ndërsa Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve përmes vendimit me numër prot:1403/2022 të datës 30.06.2022 e ka transferuar ankuesin përkohësisht nga datat 01.07.2022 deri me datë 01.10.2022 në pozitën *“Udhëheqës i Divizionit për Mbikëqyrje të Zbatimit të legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e Legjislacionit”* me arsyetimin për përmirësimin e rezultateve në punë të vetë zyrtarit.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit sikurse dhe arsyetimit të ligjshmërisë së nxjerrjes së vendimit për transfer të datës 22.06.2022, Kolegji ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë neni 6 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *“Nëpunësi civil mund të transferohet për përmirësimin e rezultateve të tij në bazë të planeve vjetore për përmirësim të rezultateve në punë brenda institucionit dhe institucioneve të administratës shtetërore. 2. Transferimi bëhet me kërkesë të nëpunësit ose të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë e cila miratohet nga njësia përgjegjëse”* dhe ka ardhur në përfundimin se sipas shkresave të lëndës të dërguara nga Njësia e Burimeve Njerëzore nën dijeni të Sekretarit të Përgjithshme të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, institucioni në fjalë nuk ka pasur plan vjetor për përmirësimin e rezultateve në punë brenda institucionit dhe po ashtu ka munguar edhe kërkesa e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankuesit respektivisht Drejtorit të Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme të cilën do të duhej më pastaj ta miratonte Njësia Përgjegjëse, andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton se në rastin konkret nuk janë plotësuar dy parakushtet e përcaktuar në mënyrë specifike mbi bazën e të cilave do të mund të llogaritej i rregullt transferi në fjalë, dhe në rastin konkret Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e lartcekura të rregullores dhe ligjit material.

Po ashtu Kolegji thekson faktin se sipas formularit të vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2021 i datës 02.02.2022 sipas gjenerimit nga sistemi i SIMBNJ ankuesi është vlerësuar me notë të përgjithshme 4.6 e cila sipas Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 e ka kuptimin e vlerësimit apo notës *“shkëlqyeshëm”* siç përcaktohet: *“nga 4.5 deri në 5 nënkupton “shkëlqyeshëm” dhe në kuptim të nenit 11 paragrafit 2 nën paragrafit 2.1 të së njëjtës rregullore vlerësohet se: “shkëlqyeshëm”, vlerësohet nëpunësi, i cili jo vetëm që ka realizuar të gjitha objektivat e punës, por ka treguar gjithashtu aftësi të punës që tejkalojnë të gjitha pritjet. Gjithashtu nëpunësi ka kontribuar në masë të madhe në realizimin e objektivave të institucionit dhe në performancën e përgjithshme të institucionit”*, andaj mbi këtë bazë të vlerësimit të rezultateve në punë, Kolegji konstaton se ankuesi i ka përmbushur objektivat e punës për vitin 2021 madje ka kontribuar edhe në realizimin e objektivave të njësisë organizative dhe në performancën e përgjithshme të institucionit,

Po ashtu, Kolegji ka analizuar edhe dispozitat e ligji Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura nënin 20 paragrafi 3 ku përcaktohet se: *“Udhëheqësi i divizionit, në rast të mungesës, zëvendësohet nga nëpunësi civil i nivelit më të lartë i të njëjtit divizion. Në rast se ka më shumë se një nëpunës civil të të njëjtit nivel, ai zëvendësohet nga nëpunësi civil i nivelit më të lartë, që ka përvojë më të gjatë në Shërbimin Civil. Në rast pamundësie shëndetësore të udhëheqësit të divizionit, zëvendësimi caktohet nga drejtori i departamentit”* ndërsa në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se në pozitën e *“Udhëheqës i Divizionit të Burimeve Njerëzore”* pozitë të cilën e mbanë ankuesi sipas Aktit të Emërimit është caktuar zëvendësuese znj. Arbnore Gjinovci përmes vendimit me numër prot:1432/2022 të datës 01.07.2022 nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, mirëpo sipas Vendimit të datës 01.07.2022 me numër prot:1431/2022 të nxjerrë nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve është konstatuar se e njëjta mban pozitën e rregullt të punës sipas aktit të emërimit *“Zyrtare Ligjore në Zyrën Ligjore”* dhe është transferuar përkohësisht në pozitën *“Zyrtare e Personelit në Divizionin e Burimeve Njerëzore”* në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit ka konstatuar se nuk është plotësuar parakushti i nevojshëm ligjor sikurse përcaktohet në nenin 20 paragrafi 3 të përcaktuar si më lartë pasi që e njëjta sipas akt të emërimit nuk është e emëruar në pozitë të përhershme në kuadër Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve dhe si i tillë Vendimi me numër prot:1432/2022 i datës 01.07.2022 i nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve është në kundërshtim me dispozitat e lartcekura ligjore dhe shfuqizohet sikurse është përcaktuar në dispozitivin e këtij vendimi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave thekson faktin se Sekretari i Përgjithshëm në cilësinë e Zyrtarit më të Lartë Administrativ me pajtim me autorizimet ligjore mund të kujdeset që nëpunësit civil të cilët janë pjesë e institucionit të njëjtë t’iu nënshtrohen procedurave disiplinore nëse ka arsye të bazuara se të njëjtët kanë kryer shkelje disiplinore mirëpo në secilin rast duhet të respektohen parimet e përgjithshme të menaxhimit të zyrtarëve publik të përcaktuar si në nenin 7 të Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *“Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mos diskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë”*, ndërsa në rastin konkret transferimi i ankuesit me arsyetimin e dhënë si në vendimin e kontestuar me këtë ankesë se, **citohet:** *“... Kohëve të fundit për shkak të shtimit të volumit të punëve për shkak të fuzionimit të MEPT-së, puna e zyrtarit po karakterizohet me lëshime të shumta profesionale të cilat po prolongojnë proceset e punës. Në mënyrë që të mos shkohet menjëherë me masa disiplinore, është parë e nevojshme që të bëhet një transferim i përkohshëm në mënyrë që mos të shkohet menjëherë me masa disiplinore, është parë e nevojshme që të bëhet një transferim i përkohshëm në mënyrë që zyrtari të ketë kohën e mjaftueshme të përmirësimit të rezultateve të punës.....”* është në kundërshtim me dispozitat e ligjit material, ngase për rastin e mënyrës së transferimit të përkohshëm me qëllim të përmirësimit të rezultateve në punës e pasquruar si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, ndërsa çështjet e përcaktimit dhe shqiptimit të masave disiplinore ndaj nëpunësve civil janë të rregulluara me nenin 48 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Andaj, Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, shkresave të lëndës si dhe konstatimeve të dhëna në arsyetimin e këtij vendimi ka konstatuar se pretendimi ankimore i ankuesit është i bazuar, ndërsa në mbështetje të nenin të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e përgjithshme Administrative neni 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 ku përcaktohet se: "Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.5. është në kundërshtim me ligjin material", e ka aprovuar ankesën e ankuesit ndërsa Vendimin numër:1403/2022 të Zv. Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve të datës 30.06.2022 për transferimin e ankuesit e ka shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa ankuesi duhet të kthehet në vendin e tij të punës sipas aktit të emërimit të datës 09.02.2015 me numër prot:47.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.600/2022

**Avdyl BEKTESHI**

*Behteshi*  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve ;
- Menaxherit të Personelit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
- Arkivit të KPMSHCK-së

